



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr._____, datë _____2026

**“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, DOKUMENTACIONIT DHE
PROCEDURAVE PËR CERTIFIKIMIN E VEPRIMTARISË SË
AGROTURIZMIT, NDËRTIMIN E STRUKTURAVE/OBJEKTEVE NË
FUNKSION TË SAJ, SI DHE MODELIT TË CERTIFIKATËS PËR USHTRIMIN
E VEPRIMTARISË SË AGROTURIZMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 45/1, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit, ndërtimin e strukturave pritëse në funksion të saj, procedurat për dhënien, ripërtëritjen, pezullimin dhe shfuqizimin e certifikatave, si dhe modelin e certifikatës për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit.

2. Parimet mbi të cilat bazohet ushtrimi i veprimtarisë së agroturizmit janë:

a) zhvillimi i veprimtarive pritëse të integruara me aktivitetin bujqësor, blegtoral, të peshkimit, akuakulturës ose veprimtari të tjera agrokulturore.

b) promovimi i tradites, biodiversitetit dhe potencialit të kapitalit njerëzor, duke nxitur veçanërisht përfshirjen e të rinjve dhe grave në zhvillimin e sipërmarrjeve të qëndrueshme në zonat rurale

c) përdorimi i burimeve lokale, nxitja e prodhimit bujqësor dhe blegtoral, zhvillimi i modeleve alternative të produkteve turistike, promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm të zonave rurale dhe krijimi i tregjeve të reja për produktet bujqësore, blegtorale dhe të akuakulturës;

ç) garantimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara nëpërmjet certifikimit të subjekteve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim;

d) mbrojtja dhe promovimi i identitetit rural, trashëgimisë kulturore, traditave lokale dhe mjedisit natyror

3. Ushtrimi i veprimtarisë pritëse të certifikuar si “Agroturizëm” lejohet vetëm për subjektet që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe janë pajisur me certifikatën përkatëse. Vetëm subjektet e certifikuara sipas këtij vendimi kanë të drejtë të përdorin në emrin e tyre tregtar ose në ambientet e tyre emërtimin “Agroturizëm”.

4. Përkufizime në kuptim të këtij vendimi:

- a) “Strukturë pritëse” është çdo strukturë që ofron për vizitorët të paktën një nga shërbimet e mikpritjes, si ushqim dhe pije, kantinë, ambiente degustimi, akomodim, aktivitete kulturore dhe edukative, shërbime kujdesi dhe mirëqenieje, ose shërbime të tjera të ngjashme, me kusht që këto veprimtari të zhvillohen brenda hapësirës së fermës ose njësisë agrokulturore ku ushtrohet veprimtaria e agroturizmit;
- b) “Veprimtari pritëse” është veprimtaria që zhvillohet në fermat bujqësore, fermat blegtorale, njësitë e peshkimit, akuakulturës ose njësitë e tjera agrokulturore, në të cilat vizitorëve u ofrohen aktivitete të lidhura me prodhimin bujqësor, blegtoral, të peshkimit, akuakulturës ose me mjedisin përreth, me qëllim argëtues, edukues ose promovues;
- c) “Fermë” është njësia ekonomike bazë në bujqësi dhe në veprimtaritë ekonomike të lidhura me të, e përbërë nga toka, objektet, pajisjet, kafshët ose resurset e tjera të përdorura për prodhimin bujqësor, blegtoral ose akuakulturor;
- ç) “Certifikatë paraprake për veprimtari pritëse Agroturizëm”, në vijim “Certifikatë paraprake”, është akti administrativ i lëshuar nga ministri përgjegjës për turizmin, me propozimin e Komisionit të Certifikimit të Veprimtarisë së Agroturizmit, për projektet e agroturizmit që i nënshtrohen procedurave të lejes së zhvillimit dhe/ose lejes së ndërtimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;
- d) “Certifikatë “Subjekt i certifikuar për veprimtarinë Agroturizëm”, në vijim “Certifikatë”, është akti administrativ i lëshuar nga ministri përgjegjës për turizmin ose personi i autorizuar prej tij, me propozimin e Komisionit të Certifikimit të Veprimtarisë së Agroturizmit, për subjektet që përmbushin kriteret dhe kushtet e përcaktuara në këtë vendim për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit;
- dh) “Komisioni i Certifikimit të Veprimtarisë së Agroturizmit”, në vijim Komisioni, është organi kolegjal i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin, përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për pajisjen me Certifikatë Paraprake, Certifikatë, ripërtëritjen, pezullimin dhe shfuqizimin e tyre;
- e) “Sekretariati Teknik i Komisionit” është struktura administrative pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, e cila administron procedurat e shqyrtimit të kërkesave dhe mbështet veprimtarinë e Komisionit;
- ë) “Produkte me origjinë nga ferma” janë produktet bujqësore, blegtorale, të peshkimit, akuakulturës ose produktet e përpunuara që prodhohen ose përpunohen në fermën ose njësinë agrokulturore ku ushtrohet veprimtaria e agroturizmit;
- f) “Produkte lokale” janë produktet e prodhuara ose të përpunuara brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ushtrohet veprimtaria e agroturizmit ose, kur kjo nuk është e mundur, brenda qarkut përkatës;
- g) “Subjekt” në kuptim të këtij vendimi janë fermerët, grupet e fermerëve, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB), organizatat e menaxhimit të peshkimit (OMP), si dhe çdo person fizik ose juridik që ushtron ose synon të ushtrojë veprimtarinë e agroturizmit në përputhje me këtë vendim. Fermerët duhet të jenë të regjistruar dhe të pajisur me identifikuesin përkatës sipas legjislacionit në fuqi, ndërsa subjektet e tjera duhet të jenë të regjistruara dhe të pajisura me NUIS/NIPT sipas legjislacionit në fuqi.

II. KRITERET PËR CERTIFIKIMIN E VEPRIMTARISË PRITËSE SI “AGROTURIZËM” DHE NDËRTIMIN E STRUKTURAVE/OBJEKTEVE NË FUNKSION TË AGROTURIZMIT

1. Veprimtaria “Agroturizëm” zhvillohet në një fermë ose njësi tjetër bujqësore që përmbush të paktën një nga kriteret e mëposhtme ose kombinimin e tyre:

a) fermë bujqësore me jo më pak se 1 (një) hektar tokë në pronësi ose përdorim, të mbjellë me kultura bujqësore;

b) fermë blegtorale, e cila disponon të paktën 0.5 (zero pikë pesë) ha tokë në pronësi ose përdorim dhe mbarëshejt të paktën një nga kategoritë e mëposhtme:

i. 10 krerë gjedhë;

ii. 100 krerë dele ose dhi;

iii. 200 krerë shpendë;

iv. 200 lepuj;

v. 50 zgjoje bletësh;

vi. 20 krerë derra;

vii. 10 krerë njëthundrakë;

viii. kombinim të të paktën dy kategorive të kafshëve të parashikuara në këtë shkronjë, ku numri i krerëve për secilën kategori të jetë jo më i vogël se 50% e pragut minimal të përcaktuar për kategorinë përkatëse.

c) njësi akuakulture, me sipërfaqe ujore jo më të vogël se 3 000 (tre mijë) m², e përdorur për kultivimin dhe rritjen e peshkut, midhjes ose organizmave të tjerë ujorë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për akuakulturën.

2. Kur veprimtaria përfshin përpunimin e produkteve bujqësore ose blegtorale, subjekti duhet të disponojë ambiente të përshtatshme për mbledhjen, prodhimin, përpunimin, ambalazhimin dhe ruajtjen e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke respektuar standardet e higjienës dhe sigurisë ushqimore.

3. Subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit ofrojnë:

a) ushqim dhe pije të përgatitura në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 5 të këtij kreu;

b) aktivitete argëtuese dhe/ose edukative të lidhura me fermën ose mjedisin përreth;

c) akomodim, si shërbim jo i detyrueshëm për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit. Në rastet kur ofrohet, struktura akomoduese duhet të ketë një kapacitet deri në 60 (gjashtëdhjetë) shtretër.

4. Struktura në funksion të agroturizmit që ofron shërbimin e ushqimit dhe pijeve duhet të ketë ambiente të përshtatshme dhe të përmbushi kërkesat e legjislacionit në fuqi për sigurinë ushqimore dhe kushtet higjieno-sanitare.

5. Produktet ushqimore dhe pijet e ofruara në subjektet e certifikuara si agroturizëm duhet të jenë:

a) jo më pak se 30% me origjinë nga ferma ose njësia bujqësore e subjektit;

b) jo më pak se 40% me origjinë lokale, brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ushtrohet veprimtaria e agroturizmit;

c) jo më shumë se 30% me origjinë tjetër.

6. Përmbushja e kriterëve të përcaktuara sipas pikës 5 të këtij kreu, vlerësohet në nivel vjetor të veprimtarisë së subjektit dhe jo për çdo furnizim apo produkt individual dhe provohet nëpërmjet dokumentacionit si më poshtë:

a) Kriteri prej jo më pak se 30% të produkteve me origjinë nga ferma ose njësia bujqësore e subjektit duhet të vërtetohet nëpërmjet dokumentacionit që provon ushtrimin e aktivitetit bujqësor ose blegtoral, regjistrave të prodhimit, dokumentacionit të fermës, si dhe faturave të shitjes së produkteve të prodhuara prej saj.

b) Kriteri prej jo më pak se 40% të produkteve me origjinë lokale duhet të vërtetohet nëpërmjet kontratave ose marrëdhënieve të dokumentuara me prodhuesit lokalë, të shoqëruara me faturat tatimore përkatëse dhe regjistrin e furnitorëve.

c) Kriteri prej jo më shumë se 30% të produkteve me origjinë tjetër duhet të vërtetohet nëpërmjet faturave tatimore dhe dokumentacionit tjetër shoqërues që provon burimin dhe origjinën e produkteve të përdorura.

ç) Çdo dokument tjetër i vlefshëm që vërteton origjinën e produkteve ushqimore.

7. Strukturat dhe objektet në funksion të agroturizmit duhet të respektojnë:

a) kushtet e zhvillimit për ndërtim, të përcaktuara në planet e përgjithshme vendore ose në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Për objekte me karakter bujqësor dhe blegtoral, në funksion të agroturizmit, duhet të plotësohen kriteret e përcaktuara në Vendimin nr. 283, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, si dhe të gjithë elementët e ndërtimit, funksionimit, higjienës dhe mjedisit të jenë të përshtatshëm, të sigurt dhe në përputhje me standardet ligjore për të garantuar mirëqenien e kafshëve, cilësinë e produkteve dhe mbrojtjen e mjedisit.

b) kushtet dhe kriteret për projektimin dhe ndërtimin e strukturave akomoduese, sipas legjislacionit në fuqi;

c) kushtet dhe kriteret për kategorizimin e strukturave akomoduese, sipas legjislacionit përkatës;

ç) karakteristikat arkitektonike të zonës, kur është e mundur.

8. Kriteret e përcaktuara në këtë vendim janë të detyrueshme për zbatim nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit në të gjitha nivelet.

9. Leja e zhvillimit dhe leja e ndërtimit për strukturat dhe objektet në funksion të agroturizmit lëshohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me dokumentet e planifikimit vendor në fuqi dhe legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

10. Në mungesë të planit të përgjithshëm vendor, zbatohen kriteret minimale të përcaktuara në këtë vendim, dhe:

a) Leja e zhvillimit dhe leja e ndërtimit lëshohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore, pas kontrollit të përputhshmërisë të projektpropozimit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), e cila në bashkërendim me ministrinë përgjegjëse për turizmin verifikon përputhshmërinë me dokumentet e planifikimit të territorit në fuqi;

b) AZHT njofton njësinë e vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe kërkuesin për rezultatet e verifikimit;

c) njësia e vetëqeverisjes vendore kryen verifikimin në terren dhe njofton AZHT për gjetjet;

ç) në rast se konstatohet përmbushja e kriterëve të përcaktuara në këtë vendim dhe e kërkesave të dokumenteve të planifikimit në fuqi, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore vendos miratimin e lejes së ndërtimit.

d) në rast se, nga verifikimet në terren, rezulton se propozimi është në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe me dokumentet e planifikimit të territorit në fuqi, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr vendim për miratimin e lejes së ndërtimit. Kur për zbatimin e lejes së ndërtimit kërkohet ndryshimi i kategorisë së përdorimit të tokës në “truell”, njësia e vetëqeverisjes vendore i paraqet kërkesë ministrisë përgjegjëse për turizmin, e cila në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë bazuar

legjislationit në fuqi, ndjek procedurën dhe përgatit projektvendimin për miratim në Këshillin e Ministrave.

dh) pas miratimit të ndryshimit të kategorisë së tokës, leja publikohet në sistemin e-leje dhe i dorëzohet kërkuarit.

III. KËRKESA DHE DOKUMENTACIONI PËR CERTIFIKIMIN E VEPRIMTARISË SË AGROTURIZMIT

1. Kërkuari për pajisjen me “Certifikatë Paraprake” ose “Certifikatë” për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit paraqet kërkesë nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, së bashku me dokumentacionin e përcaktuar në këtë kre.

2. Kërkesa shqyrtohet nga Komisioni i Certifikimit të Veprimtarisë së Agroturizmit, në përputhje me kriteret, dokumentacionin dhe procedurat e përcaktuara në këtë vendim.

3. Për pajisjen me “Certifikatë Paraprake”, kërkuari plotëson formularin e kërkesës “Për pajisjen me “Certifikatë paraprake për veprimtari pritëse të certifikuar si agroturizëm”, në portalin unik qeveritar “e-Albania” dhe ngarkon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) lejen e zhvillimit ose aktin përkatës të miratimit të zhvillimit të strukturës, ku parashikohet ushtrimi i veprimtarisë së agroturizmit, së bashku me planvendosjen e miratuar nga njësi e vetëqeverisjes vendore, fragmentin e hartës kadastrale dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme;

b) projektin teknik të plotë të strukturës së agroturizmit, të nënshkruar nga projektuesi përgjegjës, ku përfshihen elementet përbërëse të veprimtarisë, si ferma bujqësore ose blegtorale, struktura pritëse, shërbimet e akomodimit, ushqimit dhe pijeve, ambientet e degustimit, si dhe veprimtaritë ndihmëse në funksion të tyre;

c) relacionin shpjegues mbi aktivitetet bujqësore, blegtorale, të akuakulturës ose të përpunimit agroblegtoral, si dhe mënyrën e integritetit të tyre me aktivitetet turistike.

4. Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 3 të këtij kreu duhet të jetë i njëjtë me dokumentacionin e paraqitur pranë autoriteteve përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për pajisjen me leje zhvillimi ose leje ndërtimi.

5. Për pajisjen me “Certifikatë”, subjekti plotëson në portalin unik qeveritar “e-Albania” formularin e kërkesës “Për pajisjen me Certifikatë, subjekt i certifikuar për veprimtarinë agroturizëm”, dhe ngarkon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Në rastet kur ofrohet shërbimi i akomodimit:

i. Certifikatën e kategorizimit të strukturës akomoduese, nëse subjekti është i pajisur me të;

ii. në mungesë të saj, zbatohen procedurat e përcaktuara në pikën 11 të Kreut IV të këtij vendimi.

b) dokumentacionin që provon pronësinë ose të drejtën e përdorimit të strukturës pritëse ku zhvillohet veprimtaria, sipas njërit prej dokumenteve:

i. kartela e pasurisë dhe fragmenti i hartës kadastrale;

ii. akti i marrjes së tokës në pronësi;

iii. kontrata e qirasë;

iv. kontrata ku vërtetohet e drejta e përdorimit;

v. vërtetimin e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në rastet kur struktura pritëse ndodhet në zona të pamenaxhuara;

vi. certifikatë e përdorimit të ndërtimit lëshuar nga njësi e qeverisjes vendore, në rastet kur objekti nuk është pajisur me dokumentacionin e pronësisë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës;

- vii. leje legalizimi të lëshuar nga drejtoria vendore përkatëse e Agjencisë Shtetërore.
 - c) në rastet kur subjekti ushtron veprimtari të akuakulturës ose peshkimit, lejen përkatëse të ushtrimit të aktivitetit dhe genplanin e sipërfaqes ujore;
 - ç) fotografi të fermës, strukturës pritëse dhe njësisë prodhuese;
 - d) planimetrinë e strukturës ku zhvillohet veprimtaria;
 - dh) relacionin shpjegues mbi aktivitetet bujqësore, blegtorale, të akuakulturës ose të përpunimit agroblegtoral që zhvillohen në subjekt, si dhe mënyrën e integritetit të tyre me aktivitetet turistike;
 - e) vetëdeklarimin për përmbushjen e kërkesave mbi përqindjen e produkteve me origjinë nga ferma dhe ato lokale, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;
 - ë) deklaratë mbi veprimtarinë argëtuese dhe/ose edukative të lidhura me fermën ose mjedisin që do të ofrohen, së bashku me përshkrimin dhe itineraret përkatëse.
6. Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës, ministria përgjegjëse për turizmin siguron, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania” dhe sistemeve të ndërveprimit ndërinstitucional, dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) për subjektin që zotëron fermë blegtorale, vërtetimin e regjistrimit të fermës dhe numrit të kafshëve të matrikulluara, sipas kategorive, nga Sistemi i Identifikimit dhe Regjistrimit të Kafshëve (RUDA), lëshuar nga shërbimi veterinar rajonal brenda 3 (tre) muajve të fundit nga momenti që subjekti bën kërkesë në portalin “e-Albania”;
 - b) për subjektin që ushtron veprimtarinë e bletërritjes, vërtetimin e regjistrimit të fermës dhe numrit të zgjojeve të matrikulluara nga Sistemi i Identifikimit dhe Regjistrimit të Kafshëve (RUDA), lëshuar nga shërbimi veterinar rajonal, brenda 3 (tre) muajve të fundit nga momenti që subjekti bën kërkesë në portalin “e-Albania”;
 - c) për subjektin që ushtron aktivitet përpunues bujqësor ose blegtoral, dokumentin ligjor që vërteton ushtrimin e veprimtarisë përpunuese;
 - ç) për subjektin që është kategorizuar si strukturë akomoduese “Certifikatën e kategorizimit”.

IV. PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS

1. Komisioni i Certifikimit të Veprimtarisë së Agroturizmit ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.
2. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë:
 - a) 3 (tre) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për turizmin, njëri prej të cilëve caktohet kryetar, në urdhrin e ministrit;
 - b) 2 (dy) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për bujqësinë.
3. Komisioni ka këto përgjegjësi:
 - a) shqyrtimin e kërkesave për pajisjen me “Certifikatë Paraprake” dhe “Certifikatë”;
 - b) vendimmarrjen për lëshimin ose refuzimin e Certifikatës Paraprake dhe Certifikatës;
 - c) shqyrtimin e kërkesave për shtyrjen e afatit të Certifikatës Paraprake;
 - ç) vendimmarrjen për pezullimin dhe shfuqizimin e Certifikatës Paraprake dhe Certifikatës;
 - d) miratimin e ripërtëritjes së certifikatës.
4. Komisioni funksionon sipas rregullave të mëposhtme:
 - a) Komisioni mblidhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve punë nga data e plotësimit të dokumentacionit ose përfundimit të afatit për plotësimin e tij. Komisioni mund të mblidhet edhe me kërkesë me shkrim të shumicës së anëtarëve, ku përcaktohen çështjet për shqyrtim;
 - b) Kryetari i Komisionit cakton datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes;

- c) Në mungesë të kryetarit, kompetencat i ushtron anëtari më i vjetër në detyrë;
- ç) Mbledhjet e Komisionit asistohen nga Sekretariati Teknik, i cili administron dokumentacionin, përgatit materialet dhe mban procesverbalin e mbledhjes;
- d) Sekretariati Teknik njofton anëtarët e Komisionit për zhvillimin e mbledhjes dhe u vë në dispozicion dokumentacionin përkatës jo më vonë se 3 (tre) ditë pune përpara datës së mbledhjes;
- dh) Komisioni mblidhet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij;
- e) Komisioni merr vendime me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast barazimi, vota e kryetarit është vendimtare;
- ë) Anëtarët marrin pjesë në votim dhe nuk mund të abstenojnë;
- f) Anëtarët që ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit janë të detyruar të deklarojnë menjëherë këtë rrethanë dhe nuk marrin pjesë në shqyrtimin dhe votimin e çështjes përkatëse;
- g) Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, në të cilin pasqyrohen pjesëmarrësit, çështjet e shqyrtuara, votimi dhe vendimmarrja e Komisionit. Procesverbali nënshkruhet nga anëtarët pjesëmarrës;
- gj) Komisioni dhe Sekretariati Teknik janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave dhe dokumentacionit të administruar gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Shqyrtimi i kërkesës kryhet sipas procedurës së mëposhtme:

- a) Formulari i kërkesës dhe dokumentacioni ngarkohen në portalin unik qeveritar “e-Albania”;
 - b) Sekretariati Teknik kryen verifikimin paraprak të dokumentacionit;
 - c) nëse dokumentacioni është i plotë, brenda 7 (shtatë) ditëve pune i përcillet Komisionit;
 - ç) nëse dokumentacioni është i paplotë, kërkuksi njoftohet brenda 5 (pesë) ditëve pune për plotësim;
 - d) kërkuksi plotëson dokumentacionin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga njoftimi;
 - dh) në mungesë të plotësimit të dokumentacionit brenda afatit, kërkesa refuzohet;
 - e) Komisioni shqyrton dokumentacionin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga plotësimi i tij;
 - ë) kur, gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur, Komisioni çmon se nevojitet verifikimi në terren i fakteve, të dhënave ose rrethanave që lidhen me objektin e kërkesës, vendos kryerjen e verifikimit në terren nëpërmjet një grupi pune të ngritur me urdhër ministri për këtë qëllim.
 - f) grupi i punës paraqet raportin brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita e verifikimit;
 - g) Komisioni merr vendim brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e raportit;
 - gj) Në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit, Komisioni vendos:
 - i. lëshimin e “Certifikatës Paraprake”;
 - ii. lëshimin e “Certifikatës”;
 - iii. refuzimin e kërkesës.
 - h) Vendimi i Komisionit për refuzimin e kërkesës duhet të jetë i arsyetuar ku të jenë përcaktuar shkaqet faktike dhe ligjore që mbështesin refuzimin e kërkesës.
6. Pas marrjes së vendimit, Komisioni, nëpërmjet Sekretariatit Teknik, harton procesverbalin dhe i përcjell ministrit përgjegjës për turizmin vendimin përkatës për miratim, brenda 5 (pesë) ditëve pune.

7. Ministri përgjegjës për turizmin ose personi i autorizuar prej tij, miraton vendimin e Komisionit dhe urdhëron lëshimin e Certifikatës Paraprake ose Certifikatës, sipas rastit.
8. Certifikata Paraprake dhe Certifikata lëshohen në formë elektronike përmes portalit “e-Albania”, sipas modelit të shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
9. Njoftimi i subjektit për lëshimin e “Certifikatës Paraprake” ose “Certifikatës”, si dhe për refuzimin e kërkesës, bëhet nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e miratimit të vendimit përkatës.
10. Kundër vendimit për lëshimin, refuzimin, pezullimin ose shfuqizimin e Certifikatës Paraprake ose Certifikatës mund të ushtrohen mjetet e ankimit sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.
11. Në rast se kërkuesi deklaron në kërkesën për pajisje me Certifikatë se do të ushtrojë edhe veprimtari akomoduese, kërkesa për kategorizim do të shqyrtohet njëkohësisht me kërkesën për Certifikatë. Certifikata lëshohet vetëm pas pajisjes së kërkuarit me certifikatën e kategorizimit të strukturës akomoduese.
12. Monitorimi i subjekteve të certifikuara bëhet si më poshtë:
 - a) Inspektorati përgjegjës për turizmin monitoron ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve të pajisura me Certifikatë Paraprake ose Certifikatë.
 - b) Për realizimin e monitorimit, Inspektorati përgjegjës për turizmin bashkëpunon me organet tatimore, institucionin përgjegjës për sigurinë ushqimore dhe ushqimin për kafshë, si dhe institucionet e tjera kompetente sipas fushës së përgjegjësisë.
 - c) Konstatimet e monitorimit mund të shërbejnë si bazë për fillimin e procedurave të pezullimit ose shfuqizimit të Certifikatës Paraprake ose Certifikatës, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
 - ç) Inspektorati përgjegjës për turizmin harton një raport vjetor mbi rezultatet e monitorimit dhe ia paraqet ministrit përgjegjës për turizmin dhe ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural brenda muajit mars të vitit pasardhës.

V. PEZULLIMI DHE SHFUQIZIMI I CERTIFIKATAVE

1. Pezullimi i “Certifikatës Paraprake” dhe “Certifikatës”:

- a) Në rast se Komisioni konstaton, kryesisht, ose mbi bazën e verifikimeve të kryera nga organet përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore, inspektorati përgjegjës për turizmin, organet tatimore ose organet kompetente për sigurinë ushqimore dhe kushtet higjieno-sanitare, mosplotësimin ose shkeljen e një ose më shumë kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë vendim, njofton subjektin për fillimin e procedurës së pezullimit të Certifikatës Paraprake ose Certifikatës.
- b) Njoftimi i subjektit kryhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e konstatimit të ndryshimit, mospërbushjes apo shkeljes së një ose disa kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë vendim.
- c) Subjekti, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune paraqet pranë Komisionit argumente, prova apo dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterëve dhe/ose kushteve përkatëse.
- ç) Në rast se subjekti nuk provon përmbushjen e kriterëve dhe kushteve përkatëse brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c” të kësaj pike, Komisioni vendos pezullimin e Certifikatës Paraprake ose Certifikatës dhe njofton subjektin, brenda 3 (tri) ditëve pune.
- d) Vendimi për pezullimin e Certifikatës Paraprake ose Certifikatës duhet të jetë i arsyetuar.
- dh) Subjekti, të cilit i pezullohet “Certifikata paraprake” apo “Certifikata” nuk mund ta përdorë atë në ambientet e tij ose në emërtimin tregtar.

e) Në rast se provohet përmbushja e kriterëve dhe kushteve që kanë shkaktuar pezullimin, Komisioni vendos heqjen e pezullimit dhe njofton subjektin, brenda 5 (pesë) ditëve pune.

2. “Certifikata Paraprake” dhe “Certifikata” mund të shfuqizohen sipas parashikimeve të bëra në këtë vendim.

3. Komisioni, nga verifikimet e kryera kryesisht apo nga shkeljet e konstatuara nga organet përkatëse, pasi të ketë përmbushur procedurën që garanton të drejtën e subjektit për t’u informuar, për të dhënë sqarime rreth fakteve dhe për t’u dëgjuar, ka të drejtë të shfuqizojë Certifikatën paraprake apo Certifikatën, në rastin kur:

a) konstatohen të dhëna të rreme në dokumentet e kërkesës në platformën “e-Albania” për përfitimin e Certifikatës paraprake apo Certifikatës;

b) subjekti, edhe pas pezullimit të Certifikatës Paraprake ose Certifikatës, nuk përmbush kriteret dhe kushtet që kanë shkaktuar pezullimi, sipas afatit të lënë nga Komisioni ose një nga strukturat e përmendura në shkronjën “a”, pikën 1, të Kreut V, të këtij vendimi;

c) subjekti shkel në mënyrë të përsëritur një ose disa prej kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë vendim.

4. Komisioni, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e vendimit për shfuqizimin e Certifikatës paraprake ose të Certifikatës, i propozon ministrit përgjegjës për turizmin nxjerrjen e aktit të shfuqizimit.

5. Njoftimi i subjektit kryhet, brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e nxjerrjes së aktit të shfuqizimit.

6. Vendimi për shfuqizimin e Certifikatës Paraprake ose Certifikatës duhet të jetë i arsyetuar në të cilin përcaktohen faktet e konstatuara, dispozitat ligjore të zbatueshme dhe arsyet që mbështesin shfuqizimin.

7. Shfuqizimi i Certifikatës paraprake ose i Certifikatës sjell humbjen e statusit të subjektit të certifikuar për veprimtarinë e agroturizmit.

8. Në rastet kur konstatohet se subjekti, pasi është pajisur me Certifikatë Paraprake dhe më pas me Certifikatë, ka përfituar grante, përjashtime ose reduktime të taksave vendore dhe rezulton se certifikimi është përdorur në kundërshtim me qëllimin për të cilin është dhënë, duke mos ushtruar realisht veprimtarinë agroturistike ose duke e ndërprerë atë menjëherë pas përfitimit të mbështetjes publike, shfuqizimi i Certifikatës përbën shkak për humbjen e të drejtës së përfitimit dhe për fillimin e procedurave për kthimin e plotë të granteve, dhe çdo përfitimi tjetër publik të marrë në bazë të këtij certifikimi.

9. Vendimi për shfuqizimin e Certifikatës në rastet e parashikuara në pikën 3 të këtij kreu i njoftohet institucioneve kompetente që kanë akorduar përfitimet përkatëse, për ndërmarrjen e procedurave të rikuperimit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

VI. MIRATIMI I MODELIT TË CERTIFIKATËS DHE VLEFSHMËRIA

1. Certifikata përmban:

a) emërtesën e subjektit;

b) numrin unik të identifikimit të subjektit (NIPT);

c) vendndodhjen e strukturës pritëse;

ç) kategorinë e veprimtarisë së agroturizmit;

d) datën e lëshimit të certifikatës;

dh) datën e përfundimit të afatit të vlefshmërisë së certifikatës;

e) nënshkrimin e ministrit përgjegjës për turizmin ose të personit të autorizuar prej tij.

2. Certifikata paraprake apo Certifikata gjenerohet online në sistemin “e-Albania”.

3. Certifikata paraprake apo Certifikata lëshohet sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe afishohet në ambientet pritëse të strukturës së agroturizmit.

4. Certifikatat regjistrohen në Regjistrin Qendror të Turizmit, i administruar nga ministria përgjegjëse për turizmin.

5. Vlefshmëria e Certifikatës Paraprake dhe Certifikatës:

a) Certifikata paraprake është e vlefshme për periudhën e vlefshmërisë së lejes së ndërtimit për të gjithë strukturën pritëse.

b) Certifikata lëshohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje, bazuar në kërkesën e subjektit.

6. Shtyrja e afatit të Certifikatës Paraprake:

a) Në rast se subjekti nuk ka përfunduar ndërtimin e strukturës brenda afatit të vlefshmërisë së Certifikatës Paraprake, ai ngarkon në portalin unik qeveritar “e-Albania”, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e përfundimit të këtij afati, dokumentacionin e mëposhtëm:

i. kërkesën për shtyrjen e afatit;

ii. vendimin për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit ose lejen e ndërtimit të vlefshme.

b) Sekretariati Teknik ia paraqet Komisionit kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për shqyrtim.

c) Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, vendos për miratimin ose refuzimin e shtyrjes së afatit të Certifikatës Paraprake.

ç) Sekretariati Teknik njofton subjektin për vendimin e Komisionit nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.

7. Përfundimi i vlefshmërisë së Certifikatës Paraprake bëhet sipas rregullimeve të bëra në vijim.

a) Në rast se subjekti nuk paraqet kërkesë për shtyrjen e afatit sipas pikës 6 të këtij kreu, Sekretariati Teknik i paraqet Komisionit listën e subjekteve, të cilave u ka përfunduar afati i vlefshmërisë së Certifikatës Paraprake.

b) Komisioni vendos fillimin e procedurës së shfuqizimit të Certifikatës Paraprake dhe, nëpërmjet Sekretariatit Teknik, njofton subjektin duke i lënë një afat prej 14 (katërmëdhjetë) ditësh punë për të paraqitur kërkesë për pajisjen me Certifikatë ose për shtyrjen e afatit të Certifikatës Paraprake.

c) Në rast se subjekti, brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “b” të kësaj pike, nuk paraqet kërkesë për pajisjen me Certifikatë ose për shtyrjen e afatit të Certifikatës Paraprake, Komisioni konstaton humbjen e vlefshmërisë së Certifikatës Paraprake.

ç) Sekretariati Teknik njofton subjektin dhe njësinë e vetëqeverisjes vendore për humbjen e vlefshmërisë të Certifikatës Paraprake, si dhe për pasojat që rrjedhin prej tij, përfshirë detyrimin për kthimin e përfitimeve fiskale, sipas legjislacionit në fuqi.

8. Pas përfundimit të afatit kohor të Certifikatës paraprake, subjektet duhet të kryejnë kërkesën në portalin unik qeveritar “e-Albania” për pajisjen me certifikatë.

a) Subjektet që zotërojnë Certifikatë Paraprake kur objekti është përfunduar, kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për pajisjen me Certifikatë edhe përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së Certifikatës Paraprake.

9. Brenda 30 ditëve nga afati i përfundimit të vlefshmërisë së certifikatës, subjekti paraqet kërkesë për ripërtëritjen e saj në portalin unik “e-Albania” në rast se:

i. nuk ka ndryshime në strukturën akomoduese, fermën bujqësore, fermën blegtorale, njësinë e peshkimit, akuakulturës ose njësinë agrokulturore, ku të dhënat e deklaruara nga subjekti në momentin e pajisjes me Certifikatë ruhen automatikisht në sistem;

ii. kanë ndodhur ndryshime në elementët e veprimtarisë së agroturizmit, subjekti i deklaron ato në portalin unik qeveritar “e-Albania” dhe bashkëlidh dokumentacionin që vërteton ndryshimet.

VII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe ministria përgjegjëse për turizmin që, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të marrin masat për krijimin dhe funksionalizimin e shërbimit elektronik për lëshimin e Certifikatës Paraprake dhe Certifikatës në portalin unik qeveritar ‘e-Albania’. Deri në funksionalizimin e këtij shërbimi, Certifikata Paraprake dhe Certifikata lëshohen në formë fizike.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për turizmin, ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit si dhe institucionet e tjera kompetente sipas fushës së përgjegjësisë, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen:

a) Vendimi nr. 22, datë 12.1.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”, i ndryshuar;

b) Urdhri nr. 15, datë 15.1.2024, i ministrit përgjegjës për turizmin, “Për miratimin e rregullores mbi funksionimin e Komisionit të Certifikimit të Veprimtarisë së Agroturizmit, procedurat e kërkesës, vlerësimit paraprak dhe përfundimtar, si dhe pezullimin dhe/ose shfuqizimin e Certifikatës Paraprake ose Certifikatës”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Shtojca 1.

a) Certifikata paraprake



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
EMËRTIMI I MINISTRISË PËRGJEGJËSE**

CERTIFIKATË PARAPRAKE

PËR VEPRIMTARINË PRITËSE AGROTURIZËM



Kjo certifikatë i lëshohet

Subjektit _____

NIPT _____

Vendndodhja _____

Për klasifikimin si “Subjekt i certifikuar për veprimtarinë pritëse
agroturizëm”

Lëshuar më _____._____._____

E vlefshme deri më

_____._____._____

M I N I S T R I / P E R S O N I A U T O R I Z U A R

b) Certifikata



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
EMËRTIMI I MINISTRISË PËRGJEGJËSE**

CERTIFIKATË

PËR VEPRIMTARINË PRITËSE AGROTURIZËM



Kjo certifikatë i lëshohet

Subjektit _____

NIPT _____

Vendndodhja _____

Për klasifikimin si “Subjekt i certifikuar për veprimtarinë pritëse
agroturizëm”

Lëshuar më _____._____._____

E vlefshme deri më

_____._____._____

M I N I S T R I / P E R S O N I A U T O R I Z U A R